


Senatorja për fëmijët dhe edukimin



Senatorja për fëmijët dhe edukimin • Rembertiring 8-12 • 28195 Bremen

Informacioni i siguruar
Helena Justa

Për
Të gjithë Prindërit ose Kujdestarët ligjor

Dhoma 411

Tel. 0421 361-12604
Fax 0421 496-12604

E-Mail:
helena.justa@
kinder.bremen.de

Shënimi im
(ju lutem specifikojeni
në përgjigje) 30-1

Bremen, 18.06.2021

Të nderuar zonja dhe zotërinj,
të dashur prindër ose kujdestar ligjor,

që nga 1 Qershori kufijëzimet e lidhura me pandeminë në organizimin e kopshtit kanë qënë kryesisht të zbutura – zbatohet niveli bazë i të ashtuquajturit Plani i Nivelit të Reagimit. Organizimi i përditshëm i kopshtit, oferta për mbështetje por edhe aktivitete të veçanta, si vizita të fëmijëve parashkollorë në shkollën fillore, festa të vogla dhe rituale lamtumire, ekskursione etj. Janë përsëri të mundshme.

Që nga e hëna 21.06.2021 shtohen edhe lehtësime të tjera:

Maska nuk është më e detyrueshme në kopsht

Edukatorët/et nuk janë më të detyruar të përdorin maskë në kopsht – por u lejohej ta bëjnë vullnetarisht. Për fëmijet detyrimi për të mbajtur maskë është hequr prej disa javësh tashmë. Vizitorët/et mbi 10 vjeç – pra edhe prindërit dhe kujdestarët ligjor – janë të detyruar akoma të mbajnë maskë në ambientet e brendshme.

Kalimi nga kopshti në shkollën fillore

Kalimi nga kopshti në shkollën fillore është për fëmijën një ngjarje e veçantë. Fëmijët tashmë së bashku me edukatorët/et e tyre mund të bëjnë përsëri vizita në shkollat fillore, të shikojnë ambientet e klasave dhe të takojnë në ambientet e jashtme fëmijët parashkollorë dhe mësuesit. Për ta bërë këtë, fëmijëve të kopshtit u lejohej te hyjnë në ambientet e shkollës edhe pa një test.



Hyrja:
An der Weide 50

Shërbimet:
An der Weide 50
28195 Bremen

Bus/Tram:
Stacion
Stacioni qendror

Orari:
e hënë-e premte
9:00 – 14:00

Të dhënat e bankes:
Deutsche Bundesbank
DE 16 2500 0000 0025 0015 30
Sparkasse Bremen
DE 73 2905 0101 0001 0906 53

Të gjithë fëmijët lejohen së bashku në ambjentet e jashtme

Ndërkohë që në ambjentet e brendshme lejohen maksimumi vetëm 60 fëmijë të rrijnë së bashku, në ambjentet e jashtme mund të rrijnë të gjithë fëmijët. Të rriturit janë të detyruar akoma edhe në ambjentet e jashtme të mbajnë distancë nga njëri-tjetri.

Test i shpejtë për fëmijët e kopshtit akoma i mundshëm

Pavarësisht numrit të ulët të infeksioneve, disa masa parandaluese janë akoma të këshillueshme. Për këtë arsye kopshtet do tju ofrojnë akoma teste për të testuar vullnetarisht fëmijën/ët tuaj.

Gjithë të mirat

Përgjegjës

Thomas Jablonski

Shef i departamentit për edukimin në fëmijërinë e hershme, promovimin e fëmijëve dhe zhvillimin profesional të tyre.